

Kalendari i anëtarësimit në AECH.

Fazat e anëtarësimit

- I. Blerja e hardware, software dhe instalimi.
- II. Testimi dhe trainimi.
- III. Përgatitja e dokumentacionit.
- IV. Implementimi dhe kalimi në LIVE.

FAZA E PARË. Blerja e hardware dhe software, instalimi.

1. Kandidati për pjesëmarrës në AECH do të sigurojë:
 - a. serverin e AECH pjesëmarrësit si në "Server technical specifications for PS in AECH Participant Technical Requirements v1.0.doc";
 - b. S.W.I.F.T Starter Set ose ndërfaqe të tjera të komunikimit me rrjetin Swiftnet (Tipi i ndërfaqes do përcaktohet në bisedime me kompaninë SWIFT);
 - c. kompjuter personal (PC) që do të shërbejë si *webstation* i sistemit AECH Qendror. Ky kompjuter mund të jetë i njëjtë me *webstation* monitorues të AIPS ose tjetër;
 - d. ndërfaqet e serverit PS me aplikimet e tij të brendshme.
2. Banka e Shqipërisë do të sigurojë:
 - a. lexuesit e kartave (Cards Readers), kundrejt një pagese;
 - b. kartat e sigurisë për vendosjen e çertifikatave (Smart Cards), kundrejt pagesës;
 - c. PS Software, falas;
 - d. VPN Software, falas;
 - e. dokumentet e nevojshme, manuallet (falas).

FAZA E DYTË. Testimi dhe trainimi.

1. Anëtarësimi në shërbimin test **boa.aech!p** të SWIFTNET Fileact për AECH.
 - a. kandidati për pjesëmarrës duhet të plotësojë online formsin në internet përkatës në www.swift.com;
 - b. Banka e Shqipërisë miraton online formsin e kandidatit;
 - c. kompania SWIFT shton kandidatin në AECH CUG të **boa.aech!p**.
2. Testimi i shkëmbimit të skedarëve në **boa.aech!p** ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe bankës candidate.

3. Banka e Shqipërisë do të trainojë 2 ose 3 punonjës të kandidatit në sistemin AECH qendror dhe AECH pjesëmarrës.
4. Kandidati do të përgatisë formularët VPN për ambientet e testimit si në [shtojcën H](#).
5. Banka e Shqipërisë do të përgatisë përdoruesit në AECH qendror TEST, VPN, dhe çertifikatat përkatëse.
6. Banka e Shqipërisë do të instalojë, në ambientet e pjesëmarrësit software e AECH pjesëmarrës dhe VPN.
7. Kandidati në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë do të ekzekutojë scriptin e testimit dhe do ta firmosë atë.

FAZA E TRETË. Përgatitja e dokumentave.

1. Kandidati do të përgatisë “Rregullat dhe procedurat e brendshme të AECH “ të tij në përputhje me këtë rregullore.
2. Dokumentacioni i përfunduar do të dorëzohet pranë Bankës së Shqipërisë për aprovim.
3. Banka e Shqipërisë bën vërejtjet/modifikimet e saj nëse bien ndesh me këtë rregullore dhe të tjera të Bankës së Shqipërisë dhe ia pasqyron bankës kandidate.
4. Banka kandidate sjell në version përfundimtar “Rregullat dhe procedurat e brendshme të funksionimit të AECH” të përpunuara, ku ka marrë parasysh tërë korrigjimet e Bankës së Shqipërisë.

FAZA E KATËRT. Përgatitja për *LIVE* Environment.

1. Banka e Shqipërisë përgatit dhe i dorëzon pjesëmarrësit çertifikatën e anëtarësimit.
2. Kandidati dhe Banka e Shqipërisë nënshkruajnë kontratën tip për pjesëmarrje në AECH.
3. Anëtarësimi në shërbimin *LIVE* **boa.aech** të SWIFTNET Fileact për AECH:
 - a. pjesëmarrësi duhet të plotësojë online në internet formsin përkatës në www.swift.com.
 - b. Banka e Shqipërisë miraton online formsin e pjesëmarrësit;
 - c. kompania SWIFT shton pjesëmarrësin në AECH CUG të [boa.aech](#).
4. Testimi i shkëmbimit të skedarëve në **boa.aech** SWIFTNet FileACT ndërmjet pjesëmarrësit dhe Bankës së Shqipërisë.
5. Pjesëmarrësi do të plotësojë dhe do të dorëzojë pranë Bankës së Shqipërisë formularët:
 - a. si në [shtojcën D](#) për pjesëmarrje në AECH qendror;
 - b. si në [shtojcën G](#) për pajisje sigurie dhe përdorues në AECH qendror dhe AECH pjesëmarrës;
 - c. si në [shtojcën H](#) për përdorues në VPN.
6. Pjesëmarrësi do të përgatisë përdoruesit në AECH pjesëmarrës.

7. Pas aprovimit të kërkesave nga Banka e Shqipërisë krijohet profili i pjesëmarrësit në AECH qendror, përgatiten kartat e sigurisë me çertifikatat e përdoruesve, krijohen përdoruesit në ambientin Aech qendror *LIVE*, krijohen përdoruesit në VPN, i dorëzohen pajisjet e sigurisë, pjesëmarrësit..
8. Banka e Shqipërisë përcakton ditën e kalimit LIVE të pjesëmarrësit dhe njofton me email të gjithë pjesëmarrësit e AECH.
9. Kalimi LIVE.